



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

BORDI

**VENDIM
Nr. 20, datë 16.02.2012**

**PËR
MIRATIMIN E PAKETES KONTROLLUESE NË SHOQËRINË E BROKERIMIT
“P & C ALBANIA ” SH.A**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 6/n, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime”, i ndryshuar, VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës” me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Shoqëria “P & C Albania” sh.a, ushtron veprimtari brokerimi në sigurime për klasat e jo-jetës, në bazë të Licencës nr. 2, datë 26.03.2009, miratuar me Vendimin nr. 24, datë 26.03.2009, të Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare.

Aksionar i vetëm i shoqërisë është z. Mati Pepa, i cili zotëron 1.000 aksione me vlerë nominale prej 5.000 lekë secila. Me shkresën nr. 201 Prot., datë 01.02.2012 dhe nr. 208/2 prot, datë 09.02.2012 nga ana e shoqërisë së brokerimit “P & C Albania” sh.a, është depozituar njoftimi për ndryshim të aksionarit të shoqërisë i shoqëruar me :

Vendimin e aksionarit të vetëm të shoqërisë “P & C Albania” sh.a, datë 27.01.2012, z. Mati Pepa, për shitjen 100% të aksioneve të shoqërisë, noterizuar me nr.108 Rep, nr.24 Kol, datë 30.01.2012.

Kontratën e shitblerjes të aksioneve të shoqërisë “P&C Albania” sh.a, datë 30.01.2012, nr. 108 Rep dhe nr. 247 Kol, në të cilën është rënë dakord për shitjen e 1.000 aksioneve të zakonshme me vlerë nominale prej 5.000 lekë secila, midis shitësit z. Mati Pepa dhe blerësit z. Bashkim Kryeziu, me një çmim blerje 5.000.000 lekë.

Shitblerja e aksioneve është bërë konform kërkesave ligjore dhe informacioni mbi aksionarin e ri është i mjaftueshëm.

Për sa më sipër, Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Miratimin e transferimit të paketës kontrolluese në masën 100% të shoqërisë së brokerimit “P & C Albania” sh.a, tek aksionari Bashkim Kryeziu.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETAR

Enkeleda SHEHI